



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2026

Analiza ligjore:

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar; Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.01, datë 29.01.2026, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2026"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr.87/1 prot, datë 09.02.2026.

Situata financiare : Propozohet 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Qershor 2026 familje 121, me 395,485 lekë, me 5.98% e fondit total.
2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Qershor 2026 janë shpallur fitues, 859 familje, me fond 6,616,494 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 396,989 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe PAK kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 29/07/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.08 datë 13/07/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2026" paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj _____ **Zv. Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

**Komisoni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit
Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.**

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për ndryshimin e Vkb nr.74 datë 23.12.2025 "Për shtesën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas aktit normativ nr. 2 date 30.06.2026", për Bashkinë Vau Dejës"

Analiza ligjore:

Mbështetur në nenin 9, neni 34, 37, 40, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 4, kreu III, nenet 10, kreu IV, nenet 22-24, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligjin 87/2025 "Per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026, Sipas Aktit Normativ nr 2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar sipas shkresës nr 11214/3 prot datë 06.07.2026 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 2 datë 30.06.2026" dërguar nga Ministria e Financave dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës.

Situata aktuale e funksionit: Ministria e Financës me shkresën nr. 11214/3 Prot, datë 06.07.2026, me lëndë "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 2 datë 30.06.2026", ka dërguar detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Situata financiare: Konsideruar që për programin 03280 "Mbrojta nga zjarri dhe mbrojtja civile" mesatarisht gjatë viteve 2023-2025 kemi pas shpenzime shtesë për paga dhe sigurime si pasojë e oreve shtesë që kanë punuar punonjësit e zjarrefiksës ne periudhen verore në një vlerë mesatare prej 1,480,000 lekësh në vit dhe nisur nga kjo, transfertën sektoriale më vlerë prej 1,550,000 lekësh propozohet te kaloje për shpenzime për paga dhe sigurime. Kjo ne kuader te ketij shpenzimi te pritshem per vitin 2026, te bazuar ne historikun e tre viteve te fundit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ndërsa fondin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme me vlerë prej 1,166,904 lekësh propozohet të kaloje për shpenzime korente, llogaria ekonomike 602, për programin buxhetor 06260 "Shërbimet publike vendore", pasi nevojat për realizim shpenzime mirëmbajtje të zakonshme për shërbime janë gjithmonë të pranishme dhe ne rritje konsideruar amortizimin në rritje.

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisioni.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 74 datë 23.12.2025 të konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresë nr 884/1 prot datë 07.01.2026. "Për shtesën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas Aktit Normativ nr.2 datë 30.06.2026" për Bashkinë Vau Dejës.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Neki Kapllani

(emri, mbiemri, firma)

Arsen Mehmeti

(emri, mbiemri, firma)

Florin Tanushi

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Zv.Kryetar i komisionit

Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit

Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për "Miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës".

Analiza ligjore:

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, neni 34 dhe 41 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 37 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; VKB Vau Dejës nr 75 datë 23.12.2025 "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit vjetor 2027", Udhëzimit nr 7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029" dhe sipas Udhëzimit Plotësues nr 17 datë 10.07.2026 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029" dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës.

Situata aktuale e funksionit: Të ardhurat e veta të Bashkisë të kategorizuar sipas llojit të ardhurave, për periudhën 2027-2029, parashikohen në vlerat si më poshtë:

NE (MILIONE)

Vitet	2027	2028	2029
Ardhurat e veta totale	192,610	193,646	194,077
Ardhura nga taksat vendore	57,592	58,765	58,765
Ardhura nga taksat e ndara	35,284	36,072	36,938
Ardhura nga tarifat vendore	48,268	48,385	48,381
Ardhura të tjera	51,465	50,424	49,993

Të ardhurat e veta, që mbliidhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2027-2029 parashikohen që të kenë një trend rritje afersisht 1% për tre vitet e ardhshme.



Situata financiare: Shpenzimet sipas programeve per vitin 2027-2028-2029

[illegible]

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

VENDOSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Neki Kapllani _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Arsen Mehmeti _____ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Florin Tanushi _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit "Për miratimin e pranimin të grantit të akorduar nga UNDP për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, si dhe për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me VKB nr. 74, datë 23.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës"

Analiza ligjore: Në zbatim të "Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 24 "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", neni 54, shkronja "dh", si dhe neni 64, shkronja "gi"; Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; VKB-së nr 20 datë 26.03.2026 "Për miratimin e planit social vendor 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës" me shprehje ligjeshmerie nr 246/1 prot datë 08.04.2025 të Prefekti i Qarkut Shkodër, Ligjin nr. 68/2017 "Për Financat vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Ligji Nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026; Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Udhëzimin Nr.02, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026"; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.74. datë 23.12.2026 "Per miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës"; Shprehjen e Ligjshmërisë nga Prefektura Shkodër me Nr.884/1 Prot, datë 07.01.2026; Letër-Marrveshjes standarte mes përfaqësuesve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim ("UNDP") në Shqipëri dhe Bashkisë Vau Dejës (Pala Përgjegjëse) lidhur me zbatimin e programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara e projektit nr. 01005254, "Leave No One Behind" protokolluar me Nr 4910, Datë 02/07/2026.

Situata financiare: Projekti financohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim nr. 01005254, "Leave No One Behind" (ASKUSH TË MOS MBETET PAS) sipas Letër Marrveshjes protokolluar me Nr 4910 Datë 02/07/2026. Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 "Perkujdesi Social" shuma 5,809,547 (Pesë milionë e tetëqind e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Kjo nismë synon zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë Vau Dejës, duke krijuar një shërbim të specializuar, të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.



A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 29/07/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.06 datë 17/06/2026, relacionit e dokumentat shoqërues.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj  **Zv.Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për njohjen si posedues jopronarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me VKM Nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës"

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve", ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, VKM nr. 780, datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në bashkinë Vau i Dejës", si dhe të udhëzimit nr.2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive", si dhe në zbatim të procedurave të ndjekura nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetari të Bashkisë Vau Dejës nr.08, datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkuar, për tu njohur si "posedues", "jo pronarë".

Situata aktuale e funksionit: Në zbatim të procedurave të ndjekura nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetari të Bashkisë Vau Dejës nr.08, datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkuar, për tu njohur si "posedues", "jo pronarë, pasi u njohën me aplikimet e bëra nga subjektet e interesuara në portalin e-albania, mbylljes së korrespondencës zyrtare me ASHK dhe ATP, verifikimit në terren në rastet e mungesës së dëshmitarëve, dhe realizimit të afishimit 45 ditor në webin e faqes zyrtare të bashkisë si dhe pranë cdo njësie administrative ku ndodhet prona, paraqiten bashkëngjitur projekt-vendimit relacioni shpjegues përmbledhës për rastet e kualifikuara për fazën e parë të mbylljes së afishimeve publike.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria juridike e prokurimeve dhe aseteve, sektori asistences ligjore, kontratave dhe çeshtjeve gjyqesore.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë juridike të prokurimeve dhe aseteve, sektori asistences ligjore, kontratave dhe çeshtjeve gjyqesore.

Impakti social / grupet që preken: Zhvillim i zonave malore,ritje të të ardhurave të Bashkisë, ritje e numrit të të punësuarve, ritje e nivelit ekonomik të banorëve të zonave që do bëhen investimet.

Pas shqyrtimit të projekt vendimeve dhe materialeve shoqëruese,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim.
- b) miratimin e projektakteve

Kastriot Shkjau _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Mirela Vasija _____ **Zv.Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Elton Frashnaj _____ **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit „Për miratimin në parim të dhënies së drejtës së përdorimit të pasurive të paluejtshme shtetërore, sipas gjurmës së projektit të miratuar që bie në territorin e Bashkisë Vau Dejës për zhvillimin të projektit “Parku i integruar eolik dhe fotovoltaiK Kirac” me statusin e “investitorit strategjik”.

Analiza ligjore: Mbeshtetur në nenin 9 pika 1.2, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa "e/I", të ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; neni 25 pika 1/c e Ligjit Nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.6, datë 15.07.2025 "Për miratimin e statusit "investim/investitor strategjik procedurë e vecantë" për projektin e investimit "Parku i integruar eolik dhe fotovoltaiK Kirac", me subjekt "Kirac green energy" shpk Nuis M32213041L, Ligjit Nr. 57/2020 "Për pyjet", ligjin nr. 9693 date 19.03.2007 "Për fondin kullisor", i ndryshuar me Ligjin nr.111/2024 "Për disa ndryshime ne ligjin nr. 9693 date 19.03.2007 "Për fondin kullisor"; pikën 49, të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar; pika nr.22 të Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullisor publik"; VKM nr.467 datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme"; VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtarë, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusorë Pyjore.

Situata aktuale e funksionit: Dhënie në përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore pyja dhe kullota, sipas gjurmës së projektit të miratuar që bie në territorin e Vau Dejës dhe raportit teknik për zhvillimin e projektit "parku i integruar eolik dhe fotovoltaiK Kirac", me statusin e "investitorit strategjik"

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria menaxhimit te pyjeve, bujqesise dhe mbrojtjes mjedisit.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Sjell rritjen e të ardhurave të Bashkisë të cilat përkthehen në investime të shtuara si dhe sjell zhvillim ekonomik për banorët e Bashkisë Vau Dejës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pas shqyrtimit të projekt vendimeve dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim.
- b) miratimin e projektakteve

Kastriot Shkja _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Mirela Vasi _____ **Zv.Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Elton Frashnaj _____ **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për "Miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirave publike në territorin Administrativ të Bashkisë Vau Dejës sipas tekstit bashkëlidhur, në zbatim të VKM-së nr 224, datë 01.04.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike".

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji nr 8743, datë 22.01.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligji nr 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", ligji nr 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjit nr 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave dhe tarifave Vendore", ndryshuar, VKM nr 360, datë 29.05.2019, "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo territoriale në njesitë e qeverisjes vendore", si dhe në VKM-në nr 224, datë 01.04.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike".

Situata aktuale e funksionit: Referuar VKM-së nr 224, datë 01.04.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike", ndër të tjera përcaktohet edhe afati ku njesitë e qeverisjes vendore duhet të miratojnë rregulloret e brendshme për shfrytëzimin e hapësirave publike në territorin administrativ të tyre në zbatim të VKM-së sipërpërmendur.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria juridike e prokurimeve dhe aseteve, sektori asistences ligjore, kontratave dhe çeshtjeve gjyqesore.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë juridike të prokurimeve dhe aseteve, sektori asistences ligjore, kontratave dhe çeshtjeve gjyqesore.

Impakti social / grupet që preken: Projekt vendimi për Rregulloren e re, zbatimi i të cilës do shërbejë për menaxhimin më të mirë të hapësirës publike, për shërbime më të mira me interes publik, rritjen e të ardhurave për bashkinë si dhe lehtësira dhe shtim aktiviteti për biznesin e vogël.

Pas shqyrtimit të projekt vendimeve dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI


1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim.
b) miratimin e projektakteve

Kastriot Shkja  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Mirela Vasija  **Zv.Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Elton Frashnaj  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 29.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për vazhdimësinë dhe vlerën e përfitimit për znj. Matilda Terziu në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë"

Analiza ligjore: Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar), nenit 38 i Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" (i ndryshuar). VKM-së nr. 384 prot. datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM-së nr. 362 prot. datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKB-së nr. 48. datë 26.07.2021 "Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026" në Bashkinë Vau Dejës, VKB-së nr. 40, datë 28.06.2021 "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë", VKB Nr. 57 me 27.10.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr. 21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr. 33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr. 80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave". Proces-Verbal i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 15.07.2026.

Situata aktuale e funksionit: Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr. 57 me 27.10.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit.Me datë 15.07.2026, u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë të rinovuar dhe kontratës së qirasë noteriale për banoren znj. Matilda Terziu nga Komisioni i Strehimit.Komisioni i Strehimit vendosi kualifikimin e dosjes së znj. Matilda Terziu, për vazhdimin e përfitimit të subvencionit të qirasë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

reale në tregun e lirë. Subvencionit i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut, i mbledhur me datën 29/07/2026, shqyrtoi projekt vendimin "Për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për Znj. Matilda Terziu në programin e strehimit "Subvencionit të qirasë në tregun e lirë".

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj _____ **Zv. Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja _____ **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)